



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, më 17qershor2010
Ref.nr:RK13/10

VENDIM

Lënda nr. KI 06/09

Parashtruesja e Kërkesës X

kundër

Aktgjykimit të Gjykatës Supreme nr. 215/2006
Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut nr. 741/2005
Aktgjykimit të Gjykatës Komunale nr. 217/2004

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruesja e kërkesës është banor i Kosovës.

Vendimet e kundërshtuara

2. Parashtruesja e kërkesës sfidon Aktgjykimet e Gjykatës Supreme (nr.215/2006 të datës 10 qershor 2008), Gjykatës së Qarkut në P. (Ac. nr. 741/2005 të datës 28 mars 2006) dhe Gjykatës Komunale në P.. (C. nr. 217/2004 të datës 1 korrik 2005).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesja e kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e saj e garantuar me Nenin 31 të Kushtetutës (e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm).

Baza juridike

4. Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në vijim si - Kushtetuta); Neni 20 i Ligjit 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në vijim si - Ligji); dhe Neni 54(b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në vijim si - Rregullorja e Punës).

Përmbledhje e procedurës para Gjykatës

5. Parashtruesja e kërkesës, paraqiti kërkesën e saj pranë Gjykatës Kushtetuese më 15 qershor 2009. Ajo kërkoi që në vendimin e kësaj Gjykate të mos i zbulohet identiteti dhe që komunikimi të bëhet vetëm përmes telefonit.

6. Më 18 shkurt 2010, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Gjyljeta Mushkolaj, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu, brenda të njëjtës ditë i paraqiti rekomandimet e veta për të refuzuar lëndën si të palejueshme para përbërjes së plotë të Gjykatës.

Faktet

7. Më 31 qershor 2004, parashtruesja e kërkesës ngriti padi kundër personit Y pranë Gjykatës Komunale në P., duke kërkuar nga gjykata që ta urdhërojë të paditurin që t'i paguajë asaj vlerën prej 30.000 eurove si kompensim për dëme jo-materiale, në bazë të asaj se ai e ka mashtruar atë, kur i ka thënë se do të martohet me të dhe ka pasur marrëdhënie seksuale me të, ndërsa ajo ishte ende e virgjër. Sipas parashtrueses së kërkesës, i padituri, përkundër premtimit, u martua me një grua tjetër dhe me këtë, rrjedhimisht, shkeli nderin dhe dinjitetin e saj.

8. Pas urdhërimit të ekzaminimit fizik nga një institucion mjekësor publik në P., Gjykata Komunale, në vendimin e datës 1 korrik 2005, refuzoi padinë e ushtruar nga parashtruesja e kërkesës si të pabazë. Gjykata dha arsyetimin se ekspertët mjekësorë nuk ishin në gjendje të sqarojnë, nga aspekti shkencor, kohën e saktë të kryerjes së marrëdhënies seksuale gjatë të cilës ajo kishte humbur virgjërinë, dhe për këtë arsye, nuk kishte mundur të përcaktojë përgjegjësinë civile të të paditurit.

9. Ndaj këtij Aktgjykimi, parashtruesja e kërkesës ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në P., duke pretenduar se Gjykata Komunale i ka shkelur dispozitat themelore të Ligjit për Procedurën Kontestimore; ka vlerësuar faktet në mënyrë të gabuar e jo të plotë, dhe në mënyrë të gabuar e ka aplikuar të drejtën materiale. Për

këto arsye, sipas parashtresës së parashtgueses së kërkesës, ky rast duhej rigjykuar.

10. Me vendim të datës 28 mars 2006, Gjykata e Qarkut në P., konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe refuzoi ankesën e parashtgueses së kërkesës si të pabazuar. Gjykata dha arsyetimin se argumentet e parashtgueses së kërkesës, se aktgjykimi i Gjykatës Komunale bazohej në vlerësim të gabuar e jo të plotë të fakteve dhe aplikonte të drejtën materiale në mënyrë të gabuar, ishin të pabaza. Gjykata më tej theksoi se, gjykata e shkallës së parë kishte aplikuar të drejtën materiale në mënyrë të drejtë dhe përcaktoi se i padituri nuk do të detyrohej të paguaj kompensime për dëme jo-materiale. E njëjta vlerësoi se Aktgjykimi ishte gjithëpërfshirës dhe i arsyeshëm, në pajtim me Nenin 354 (14) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

11. Më 21 gusht 2006, parashtguesja e kërkesës paraqiti kërkesë për revizion pranë Gjykatës Supreme, me argumentin se aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë, ishin marrë duke shkelur dispozitat themelore të procedurës kontestimore, pa vlerësim të fakteve dhe duke aplikuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar.

12. Parashtguesja e kërkesës i kishte shkruar Ombudspersonit, ku ankohej se Gjykata Supreme nuk kishte marrë ende vendim. Ajo nuk zbuloi rezultatin e komunikimit mes Ombudspersonit dhe Gjykatës Supreme.

13. Më 10 qershor 2008, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtgueses së kërkesës për revizion si të pabazuar, për arsye se revizioni nuk mund të kërkohej për shkak të vlerësimit të gabuar, apo jo të plotë, të situatës faktike.

Pretendimet e parashtgueses së kërkesës

14. Parashtguesja e kërkesës, në kërkesën e saj, ankohet për shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës (e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm), pa e shtjelluar çështjen më tej.

Vlerësimi për lejueshmërinë e kërkesës

15. Fillimisht, Gjykata dëshiron të theksojë se ajo nuk është gjykatë apeli për gjykatat e tjera në Kosovë, dhe nuk mund të intervenojë mbi bazën e asaj se ato gjykata kanë marrë vendime të gabuara, apo kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve. Roli i Gjykatës është vetëm të sigurojë pajtueshmëri me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, dhe për këtë arsye ajo nuk mund të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" (shih, *mutatis mutandis*, *Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R.J.D., 1996-IV, para. 65).

16. Për t'i mundësuar Gjykatës vërtetimin e shkeljeve të mundshme të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, është e domosdoshme që në kërkesë të përfshihen arsyetime procedurale dhe substanciale, informata dhe dokumente mbështetëse, në pajtim me Nenin 22.1 të Ligjit dhe Nenin 29(1)(f) dhe (g) të Rregullores së Punës së Gjykatës. Lidhur me ankesën e parashtgueses së kërkesës, se procedurat para gjykatave të tjera nuk kanë qenë të drejta dhe të paanshme, Gjykata duhet të

ekzaminojë nëse parashtuesja e kërkesës i ka plotësuar këto kushte të lejueshmërisë.

17. Megjithatë, Gjykata konsideron se në kërkesën e saj, parashtuesja e kërkesës nuk arrin të demonstrojë se e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është shkelur dhe se ankesa e saj kushtetuese është arsyetuar në aspektin procedural dhe substancial.

18. Për më tepër, Gjykata konsideron se kërkesa nuk përmban asgjë që tregon se shqyrtimi i lëndës në gjykata nuk është bërë në mënyrë të paanshme, apo se procedurat ishin zhvilluar në mënyrë të padrejtë. Fakti se parashtuesja e kërkesës është e pakënaqur me rezultatin e lëndës në vetvete, nuk mund të përbëjë bazë për argumentim të kërkesës për shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, aktgjykimin e GJEDNj Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, aktgjykim i datës 26 korrik 2005).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit si dhe Nenin 54(b) të Rregullores së Punës, unanimisht,

VENDOS

- I. TË HEDHË POSHTË kërkesën si të palejueshme
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Dr. Gjyljeta Mushkolaj

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

